



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 350, datë 06.07.2023**

**PËR**

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtarit {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

---

# ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

## 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.*

### 1.A. NJOHURITË LIGJORE

#### 1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njej ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në vijim, analizohet mënyra se si janë evidentuar këta elementë ligjor në vendimet burim vlerësimi për gjyqtarin {...}.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës dhe është emëruar gjyqtar në datën 23.01.2014. Ai ka njohuri akademike shumë të mira dhe i shfaq ato sidomos në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ai i kushton rëndësi përcaktimit të faktit të mosmarrëveshjes, identifikon natyrën e mosmarrëveshjes, identifikon normën materiale të zbatueshme dhe ndalet gjatë në analizimin e saj, duke përdorur disa metoda interpretimi.....3 dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë mbi përgjegjësinë penale për veprat penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake (shih dokumentin 1), të shpërdorimit të detyrës (shih dokumentin 2). Të vjedhjes së energjisë elektrike (shih dosjet 1 dhe 2), njohuritë mbi shpërblimin e dëmit nga marrëdhëniet e punës (shih dokumentin 3) apo shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor (shoh dosjen 4), njohuritë mbi procedurën e vërtetësisë së akteve (shih dosjen 3), si dhe njohuritë mbi zgjidhjen e martesës”.*

**Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:**

***Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes***, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit. Evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre por, në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Në vendimet civile, evidentohet se gjyqtari tregon kujdesin e duhur që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile, të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.<sup>1</sup>

Në vendimet penale, referuar natyrës së gjykimit (*gjykim penal themeli*), apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*) evidentohet se gjyqtari tregon kujdesin e duhur, duke përshkruar faktin penal sikurse ai ka rezultuar i provuar në gjykim, nga tërësia e provave të administruara. Në një rast, evidentohet kujdesi i gjyqtarit që pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e prokurorisë, të bëjë një përcaktim të ndryshëm të faktit penal, në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale.<sup>2</sup> Rrethanat e faktit vijnë menjëherë pas prezantimit të çështjes dhe arsyetimit lidhur me juridiksionin, kompetencën apo kërkesat procedurale të palëve, sikurse është rasti i pranimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar.<sup>3</sup>

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes në të gjitha vendimet e nënshtruara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, familjar apo gjykim penal*) rrethanat e fakteve parashtrohen në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit.

---

<sup>1</sup>Vendimi nr.279, datë 08.10.2015

<sup>2</sup>Vendimi nr.116, datë 23.04.2015

<sup>3</sup>Vendimi nr.116, datë 10.10.2016 23.04.2015, vendimi nr.310, datë 12.11.2015, vendimi nr.296, datë 04.11.2015, vendimi nr.200, datë 22.09.2016, vendimi nr.199, datë 19.09.2016, vendimi nr.162, datë 02.07.2014 dhe vendimi nr.289, datë 11.12.2014

Evidentohet analizë e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në lidhje me marrëdhënien juridike civile ndërmjet palëve në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

### ***-Identifikimi i natyrës së çështjes***

Në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, e cila orienton më pas ndërtimin e një strukture specifike në organizimin e arsytimit të vendimeve, në çështje me natyra të ndryshme (*penale themeli, çështje familjare, çështje civile të përgjithshme dhe çështje marrëdhënie pune*). Pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, gjyqtari përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje pronësie, marrëdhënie pune, kthim shume etj.*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), si dhe llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri në çështjet penale.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj. Në pjesën e parë përshkruese-arsyetuese të disa prej vendimeve burim vlerësimi gjyqtari analizon pa u zgjatur, juridiksionin dhe kompetencën (*lëndore dhe tokësore*) për shqyrtimin e çështjes. Nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që natyra juridike e çështjes është evidentuar pothuajse në të gjitha çështjet e trajtuara por, edhe ku nuk është identifikuar në mënyrë specifike, ajo del qartë referuar identifikimit të elementeve dhe kriterëve ligjore të mosmarrëveshjes juridike në çdo vendim gjyqësor burim vlerësimi.

### ***- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes por, gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (*i*) vendime civile/familjare dhe (*ii*) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material por, edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e kërkesave apo situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (*mosmarrëveshje pronësie, kthim shume, dëmshpërblim që rrjedh nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, zgjidhje martese, etj*), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, të Kodit të Punës apo të Kodit të Familjes, nga ku evidentohet më konkretisht se:

- a) Në vendimet me objekt “Dëmshpërblim nga marrëdhëniet e punës”, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 21/4, 141, 143, 144, 146, 149, 145/2 dhe 153, 154/3, 155 të K.Punës, në funksion të përkufizimit të marrëdhënies juridike të punës, llojin e kontratës,

formën dhe përmbajtjen e saj, afatin dhe shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës, procedurën e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, dëmshpërblimin për mosrespektim të afatit dhe procedurës, si dhe pagimin e vjetërsisë në punë. Lidhur me respektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, gjyqtari referon nenet 8 dhe 9 të Konventës nr.158 të ONP “Për ndalimin e punësimit me iniciativën e punëdhënësit”;<sup>4</sup>

- b) Në vendimin me objekt “Lirim, dorëzim sendi” gjyqtari identifikon normën relevante për zgjidhjen e çështjes, nenin 296 të K.Civil në lidhje me padinë reale të kërimit të sendit (*padia e rivendikimit*);<sup>5</sup>
- c) Në vendimin me objekt “Zgjidhje martesë”, gjyqtari identifikon dhe citon dispozitat ligjore familjare (*nenin 132, 133, 146, 143 të K.Familjes*) në lidhje me zgjidhjen e martesës ligjore ndërmjet palëve, si dhe zgjidhjen e pasojave që rrjedhin prej saj;<sup>6</sup>
- d) Në vendimin me objekt “Shpërblim dëmi”, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 608 dhe 609 të Kodit Civil në lidhje me shkaktimin e dëmit jashtëkontraktor dhe nenin 622 të K.Civil lidhur me përgjegjësinë nga ushtrimi i një veprimtarie të rrezikshme.<sup>7</sup>

Krahas dispozitave të Kodit të Familjes në vendimin me objekt “zgjidhje martesë”, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozita të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës. Konkretisht, nenin 53 të Kushtetutës, si dhe nenin 8 të KEDNJ në funksion të evidentimit të së drejtës për të lidhur martesë dhe për të krijuar familje.<sup>8</sup>

Në vendimet gjyqësore evidentohet citimi i dispozitave procedurale civile të cilat kanë lidhje, si më zgjidhjen përfundimtare të çështjes, ashtu edhe në funksion të zgjidhjes së çështjeve dhe kërkesave procedurale. Konkretisht identifikohet:

- a) nenet 35/3 36/1, 41, 42, 43, 51, 59, 349, 510/a, 511/a të K.Pr.Civile dhe nenin 7 të Kodit të Punës,<sup>9</sup> lidhur për përcaktimin e juridiksionit gjyqësor, kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve, referuar objektit të tyre (*çështje me objekt kërkim sendi, zgjidhje martesë, kthim shume, marrëdhënie pune, njohje e vërtetësisë së dokumentit, etj.*); nenet 71, 72 dhe 73 të K.Pr.Civile në lidhje me shkaqe të papajtueshmërisë apo përjashtimit;<sup>10</sup>
- b) nenet 193 dhe 194 të K.Pr.Civile në lidhje me thirrjen në gjykim të personit të tretë;<sup>11</sup>
- c) nenet 11, 12, 15, 28 dhe 29 të K.Pr.Civile lidhur me përcaktimin e barrës së provës, në funksion të disponimit të gjykatës lidhur me rrëzimin e padisë;<sup>12</sup>
- d) nenet 32/c, 253 dhe 254 të K.Pr.Civile lidhur me padinë e njohjes për vërtetësinë ose pavërtetësinë e dokumentit, si dhe lidhur me fuqinë e plotë provuese të akteve zyrtare të dala nga nëpunësit e shtetit apo personat që ushtrojnë një veprimtari publike;<sup>13</sup>
- e) nenin 106 të K.Pr.C lidhur me shpenzimet gjyqësore;<sup>14</sup>

<sup>4</sup>Vendimi nr.41, datë 18.02.2015, vendimi nr.123, datë 14.04.2016 dhe vendimi nr.227, datë 28.07.2016

<sup>5</sup>Vendimi nr.279, datë 08.10.2015

<sup>6</sup>Vendimi nr.304, datë 22.10.2014

<sup>7</sup>Vendimi 304, datë 22.10.2014

<sup>8</sup>Vendim nr.304, datë 22.10.2014

<sup>9</sup>Vendimi nr.123, datë 14.04.2016 dhe vendimi nr.41, datë 18.02.2015

<sup>10</sup>Vendimi nr.131, regji, datë 03.06.2014

<sup>11</sup>Vendimi nr.68, datë 05.03.2014

<sup>12</sup>Vendimi nr.229, datë 15.07.2014

<sup>13</sup>Vendim nr.68, datë 05.03.2014

(ii) Në vendimet penale, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, ashtu edhe dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.

- a) Konkretisht, identifikohet neni 248 të K.Penal në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorim detyre*”;<sup>15</sup> nenin 305 të K.Penal në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale “*Kallëzim i rremë*”;<sup>16</sup> nenin 145 të K.Penal në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale “*Mashtrim në sigurime*”;<sup>17</sup> neni 137/1/2 të K.Penal në lidhje me akuzën “*Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike*”;<sup>18</sup> neni 278/2/4 të K.Penal në lidhje me akuzën për kryerjen e veprës penale “*Prodhimi dhe mbajtja pa leje të armëve luftarake dhe municionit*”;<sup>19</sup> neni 291 të K.Penal në lidhje me akuzën “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”;<sup>20</sup>
- b) Në ato raste kur për cilësimin juridik të veprës penale që i atribuohet të pandehurit dhe me qëllim përcaktimin e përgjegjësisë penale të tij, nevojitet referimi në ligje të tjera organike, identifikohet ligji organik përkatës. Konkretisht, në analizën e objektit të figurës së veprës penale të “*Drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt*”, gjyqtari referon Kodin Rrugor, pa identifikuar ndonjë nen specifik të tij.<sup>21</sup> Po ashtu, në analizën e anës objektive të veprës penale “*Shpërdorim detyre*”, duke qenë se kjo është një dispozitë *blankete*, gjyqtari në funksion të analizës nëse i pandehuri ka shpërdoruar detyrën e caktuar me ligj, referon dhe citon nenet 4, 21, 39 dhe 45 të ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “*Për urbanistikën*”, i ndryshuar, si dhe nenin 120, pika “d” të “*Rregullores së urbanistikës*”, të miratuar me VKM nr.722, datë 19.11.1998;<sup>22</sup>
- c) Në çdo rast, referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje moshën për përgjegjësi penale (*neni 12 i K.Penal*), fajin si element i domosdoshëm i anës subjektive të veprës penale (*neni 14 të K.Penal*), qëllimin e dënimit penal (neni 1/b i Kodit Penal), në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*),<sup>23</sup> dispozitën lidhur me aplikimin e zëvendësimit të dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit, (*neni 53/a të Kodit Penal*),<sup>24</sup> dispozitën lidhur me dënimin plotësues për heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike (*neni 35 i K.Penal*),<sup>25</sup> dispozitat lidhur me dënimet alternative (*neni 59 i K.Penal*),<sup>26</sup> etj.

---

<sup>14</sup>Vendimi nr.279, datë 08.10.2015, vendimi nr.41, datë 18.02.2015, vendimi nr.123, datë 14.04.2016 dhe vendimi nr.227, datë 28.07.2016

<sup>15</sup>Vendimi nr.310, datë 12.11.2015

<sup>16</sup>Vendim nr.296, datë 04.11.2015

<sup>17</sup>Vendim nr.200, datë 22.09.2016

<sup>18</sup>Vendim nr.199, datë 19.09.2016 dhe vendimi nr.162, datë 02.07.2014

<sup>19</sup>Vendimi nr.116, datë 23.04.2015

<sup>20</sup>Vendim nr.289, datë 11.12.2014

<sup>21</sup>Vendimi nr.289, datë 11.12.2014

<sup>22</sup>Vendimi nr.310, datë 12.11.2015

<sup>23</sup>Vendimi nr.369, datë 23.07.2014, nr.320, datë 01.07.2014, nr.151, datë 1.03.2015 dhe nr.358, datë 27.09.2016 të

Gjykatës së Rrethir Gjyqësor Dibër

<sup>24</sup>Vendimi nr.289, datë 11.12.2014

<sup>25</sup>Vendimi nr.310, datë 12.11.2015

<sup>26</sup>Vendimi nr.162, datë 02.07.2014

Në lidhje me identifikimin e dispozitave procedurale penale, gjyqtari referon, si pjesë e integruar e arsyetimit të vendimit, dispozita të ligjit procedural penal:

- a) nenet 69/1, 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, sa i përket vlerësimit të çështjes së juridiksionit dhe kompetencës lëndore dhe tokësore të gjykatës për gjykimin e çështjeve penale, nenin 13/3 në lidhje me përbërjen e trupit gjykues;<sup>27</sup>
- b) nenet 403 dhe 404 të K.Pr.Penale, lidhur me procedimin me gjykim të shkurtuar, nenin 406 të K.Pr.Penale, lidhur me mënyrën e caktimit të dënimit në rastet e procedimit me këtë lloj të posaçëm të gjykimit;
- c) nenet 393/1 dhe 485 të K.Pr.P lidhur me shpenzimet procedurale dhe gjyqësore në procesin penal;
- d) nenin 375 në lidhje ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale, nenin 388 të K.Pr.Penale në rastin e deklarimit të pafajshëm të autorit, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;<sup>28</sup>
- e) nenin 283 i K.Pr.Penal në lidhje me depozitim të kallëzimit.<sup>29</sup>

***Sa i përket konfliktit të normave***, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive materiale në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

## **1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES**

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

<sup>27</sup>Vendimi nr.116, datë 23.04.2015

<sup>28</sup>Vendimi nr.116, datë 23.04.2015

<sup>29</sup>Vendimi nr.296, datë 04.11.2015

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Ai i kushton rëndësi përcaktimit të faktit të mosmarrëveshjes, identifikon natyrën e mosmarrëveshjes, identifikon normën materiale të zbatueshme dhe ndalet gjatë në analizimin e saj, duke përdorur disa metoda interpretimi. Ai ka prirje për të shpjeguar qëllimin e normës materiale, si dhe evidenton nga pikëpamja teorike institutet kuqe të mosmarrëveshjes. Njeh dhe përdor gjerësisht parimet e përgjithshme të së drejtës dhe jurisprudencën e gjykatave më të larta”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore materiale citohen ose referohen, duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile ose të çështjes penale objekt shqyrtimi. I njëjti kujdes i gjyqtarit nuk evidentohet në rastin e interpretimit të dispozitave procedurale civile, kur ato janë drejtpërdrejt të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes. Mungesa e kompleksitetit të çështjeve referuar natyrës së mosmarrëveshjeve civile, jo gjithmonë justifikon mungesën e arsytimit të dispozitës procedurale.

***- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm***

Sa i përket interpretimit të ligjit material të zbatueshëm, sipas natyrës së vendimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast interpreton dispozitat respektive të zbatueshme në mënyrë të pavarur. Në vendimet penale dhe ato civile dispozitat materiale të zbatueshme, në çdo rast interpretohen para se të aplikohen mbi faktet e provuara, duke u zbërthyer në elementët e tyre përbërës e qëllimin e dispozitës.

*(i) Në vendimet civile burim vlerësimi*, interpretimi i normës juridike bëhet duke identifikuar qëllimin e normës, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë që të gjejë zbatim dispozita, në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari:

- interpreton nenin 153 të K.Punës në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, që të legjitimojnë punëdhënësin që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me punëmarrësin. Më tej, gjyqtari analizon nenin 144 të K.Punës, për të verifikuar nëse nga ana e punëdhënësit është respektuar procedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke e mbështetur këtë analizë edhe në nenet 8 dhe 9 të Konventës nr.158 të ONP “Për parandalimin e punësimit me iniciativën e



*punëdhënësit*”;<sup>30</sup> Lidhur me kërkimin për shpërblimin për vjetërsi gjyqtari interpreton në mënyrë literare nenin 145 të K.Punës, në lidhje me dy kushtet ligjore që duhen të plotësohen në mënyrë kumulative për të legjitimuar paditësin për kërkimin e shpërblimit për vjetërsi në punë;<sup>31</sup>

- interpreton në mënyrë sistematike nenet 608 dhe 609 të K.Civil në funksion të përcaktimit të katër kushteve që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për të provuar ekzistencën e përgjegjësishë jashtëkontraktore dhe shpërblimin përkatës (*dëmi, paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit, faj, dhe lidhja shkaktore*);<sup>32</sup>
- interpreton në mënyrë sistematike dispozitën kushtetuese (*nenin 53*) me nenin 8 të KEDNJ, si dhe me nenin 50 të K.Familjes, në funksion të analizimit të institutit të martesës. Në këtë kontekst, gjyqtari referon në *parimin e autonomisë së vullnetit të palëve në lidhjen e martesës*. Interpreton dispozitën materiale, nenin 132 të K.Familjes, lidhur me mbarimin e martesës nëpërmjet një prej formave të saj (*konkretisht zgjidhjes së saj*), duke u ndalur tek shkaqet e zgjidhjes së martesës. Gjithashtu, gjyqtari interpreton dhe zbaton sanksionimin e parashikuar në nenin 146/1 të K.Familjes në lidhje me ndryshimin e mbiemrit të bashkëshortit tjetër si një ndër pasojat *ipso lege* të zgjidhjes së martesës në rastin konkret.<sup>33</sup>

Në vendimet e tjera civile të analizuar, dispozitat janë cituar dhe zbatuar drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa u shoqëruar me një interpretim të pavarur të tyre, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e thjeshtë e objektit të padive të trajtuara.

(ii) *Në vendimet penale burim vlerësimi*, gjyqtari citon nenet e pjesës së posaçme të Kodit Penal dhe i interpreton ato në drejtim të vlerësimit lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, si dhe analizës së elementëve të anës objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën procedohet i pandehuri. Në këto vendime interpretohen gjithashtu dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, sa i përket përcaktimit të qëllimit të dënimit penal, kushteve dhe kritereve ligjore të individualizimit të dënimit, si dhe aplikimit të masave alternative të dënimit me burgim. Interpretimi i dispozitave të ligjit penal material, në disa raste, duke iu referuar natyrë së dispozitës dhe elementëve të saj, pasurohet me qëndrime të praktikës gjyqësore, siç është rasti i përcaktimit të natyrës së veprës penale si krim vazhdues, apo si një figurë e vetme krimi. Konkretisht, interpretohen në aspektin teorik duke u dhënë kuptimi dhe qëllimi i dispozitës, nenet 278/4, 137/1, 291, 248, 305 dhe 145 të Kodit Penal, të cilët analizohen në mënyrë të plotë në të katër elementët e figurës së veprës penale (*objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive*), para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes. Në një rast gjyqtari është ndalur në analizën e thelluar të anës objektive dhe subjektive të veprës penale të “Mashtimit në sigurime” (neni 145 i K.Penal) për të përcaktuar natyrën e veprës penale, formën e kryerjes së saj, cilësimin e saj si krim vazhdues, si dhe në qëllimin e veprës penale konkrete. Ky interpretim abstrakt dhe i zgjeruar i dispozitës, duke dhënë edhe kuptimin e krimit vazhdues, si dhe nocionin e “gënjeshtrës” si formë e kryerjes së veprës në aspektin teorik, pasurohet edhe me referimin dhe citimin e qëndrimeve të praktikës gjyqësore (*referohet qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 354, datë 20.12.2012, vendimin nr.12, datë 16.01.2013 dhe vendimin unifikues nr.284, datë 06.10.2000*) lidhur me këto dy koncepte, duke i dhënë qartësi dhe bazueshmëri konkluzioneve të gjyqtarit lidhur me këto dy aspekte të interpretimit të dispozitës konkrete.<sup>34</sup> Po kështu, në rast kur dispozita penale materiale ku të referon fakti penal është një

<sup>30</sup>Vendimi nr.227, datë 28.07.2016 dhe vendimi nr.123, datë 14.04.2016

<sup>31</sup>Vendimi nr.41, datë 18.02.2015

<sup>32</sup>Vendimi nr.176, datë 10.06.2015

<sup>33</sup>Vendimi nr.304, datë 22.10.2014

<sup>34</sup>Vendimi nr. 112, datë 22.07.2015

dispozitë *blankete*, gjyqtari për të përcaktuar anën objektive të veprës penale të “*Shpërdorimit të detyrës*”, i referohet ligjit nr.8405, datë 17.09.1998 “*Për urbanistikën*”.<sup>35</sup>

*Në vendimet penale të themelit* gjyqtari ka interpretuar edhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në drejtim të përcaktimit të qëllimit të dënimit penal, kushteve dhe kritereve të individualizimit të dënimit, sipas parashikimeve të nenit 47 të Kodit Penal, si dhe kushteve të aplikimit të pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit, sipas parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, kushte të cilat referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet e çështjes, duke u shoqëruar me një analizë të shkurtër të tyre, pa qëndruar në interpretimin e veçantë dhe abstrakt të tyre.<sup>36</sup> Në një rast evidentohet se për të interpretuar “*rrezikshmërinë e veprës penale*” dhe “*rrezikshmërinë e autorit të saj*”, gjyqtari i referohet në mënyrë orientuese Udhëzimit nr.2, datë 14.03.1979, të Plenumit të Gjykatës së Lartë.<sup>37</sup>

- ***Në drejtim të interpretimit të ligjit procedural***

Nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi interpretimit të disa dispozitave procedurale që zbatohen mbi rrethanat procedurale, duke u ndalur vetëm në disa raste në interpretimin teorik të tyre dhe në shumicën e rasteve në aplikimin e drejtpërdrejtë të tyre mbi faktet e çështjes.

*Në vendimet penale të analizuara*, rezulton:

- interpretimi i nenit 404 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet procedurale të pranueshmërisë së kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar, duke u shoqëruar ky interpretim me referimin e praktikës gjyqësore, konkretisht, vendimit nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- interpretimi i nenit 283 i K.Pr.Penale lidhur me formën e paraqitjes së kallëzimit penal (*me gojë ose me shkrim*) në funksion të analizës së anës objektive të figurës së veprës penale “*Kallëzim i rremë*”.<sup>38</sup>

*Në vendimet civile të analizuara*, sa i përket ligjit procedural kur ai është drejtpërdrejt i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, konkretisht referuar vendimit civil nr.68 dt. 05.03.2014, përmbajtja e normave, neneve 32/c dhe 253 dhe 254 të K.Pr.Civile, citohet në vendim, pa u bërë interpretim i tyre me vete dhe sistematik me njëra tjetrën. Në vendim nuk analizohen kushtet e zbatimit të nenit 32/c të K.Pr.Civile përballë ekzistencës së akteve zyrtare me fuqi të plotë provuese. Kjo mungesë interpretimi e bën të paqartë në vijim, mënyrën se si këto dispozita janë bërë të zbatueshme mbi faktet e provuara në gjykim. Mungesa e interpretimit në këtë rast nuk është kushtëzuar nga objekti i mosmarrëveshjes së trajtuar, përkundrazi ka qenë i nevojshëm, për të kuptuar deduksionin logjik të përdorur në konkluzionin e arritur për zgjidhjen e çështjes.

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.***

<sup>35</sup>Vendimi nr.310, datë 12.11.2015

<sup>36</sup>Vendimi nr.199, datë 19.09.2016, vendimi nr.162, datë 02.07.2014, neni 116, datë 23.04.2015, vendimi nr.296, datë 04.11.2015, vendimi nr.289, datë 11.12.2014 dhe vendimi nr.200, datë 22.09.2016

<sup>37</sup>Vendimi nr.310, datë 12.11.2015

<sup>38</sup>Vendimi nr.296, datë 04.11.2015

Në disa nga vendimet e analizuara, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese*), në mbështetje të argumenteve të tij në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet që lidhen me:

- a) *Gjykimin e shkurtuar dhe kushtet e aplikimit të tij*. Rezulton se nga ana e gjyqtarit është cituar dhe zbatuar në drejtim të vlerësimit për pranimin e kërkesës për të proceduar më gjykim të shkurtuar, vendimi unifikues nr. 2, datë 29.01.2003, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- b) *Naturën e veprës penale të “Mashtimit në sigurime”* dhe cilësimin juridik të faktit penal sipas kësaj figure të veprës penale, dhënien e kuptimit të nocionit “gënjeshër”, si formë e kryerjes së kësaj vepre penale, për të cilën referohet qëndrimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 354, datë 20.12.2012, si dhe kuptimin e krimit vazhdues dhe karakteristikat e një vepre penale në drejtim të elementëve të anës objektive dhe subjektive për t’u cilësuar si krim vazhdues, duke iu referuar qëndrimit të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 284, datë 06.10.2000 dhe vendimin nr.12, datë 16.01.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.<sup>39</sup>
- c) Vendimin nr. 23, datë 23.07.2009, të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë;<sup>40</sup>
- d) Në funksion të analizë të subjektit dhe anës objektive të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, gjyqtari referon në vendimin nr.536, datë 27.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, në këtë vendim gjatë analizë së formës së kryerjes së veprës penale, atë të dashjes direkte, gjyqtari referon në vendimin nr.358, datë 09.07.2008 të Kolegjit Penale të Gjykatës së Lartë; në lidhje me qëllimin e dënimit penal, i cili duhet të përmbushë dy funksione të ndryshme, si funksionin e parandalimit të përgjithshëm, ashtu edhe funksionin e parandalimit të posaçëm, referohet vendimi nr.47, datë 26.07.2012 të Gjykatës Kushtetuese, etj.<sup>41</sup>

#### ***-Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës***

Nga tërësia e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtari gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet në disa raste duke i përmendur ato shprehimisht, dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsytimit dhe analizës ligjore të vendimit. Nga tërësia e vendimeve rezulton se gjyqtari njih dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- a) *Parimi i prezumimit të pafajësisë* të sanksionuar në nenin 4 të K.Pr.Penale dhe parimin procedural penal që ka lidhje të drejtpërdrejtë me përcaktimin e përgjegjësisë penale të autorit “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”;<sup>42</sup>
- b) *Parimin e ligjshmërisë – nullum crimen, nulla poena sine culpa*, i nxjerrë nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur në të gjitha vendimet penale të themelit në të cilat gjyqtari analizon domosdoshmërinë e ekzistencës dhe provueshmërisë së të katër elementëve të figurës së veprës penale, si kusht për ekzistencën e saj dhe për pasojë, për

<sup>39</sup>Vendimi nr.200, datë 22.09.2016

<sup>40</sup>Vendimi nr.116, datë 23.04.2015

<sup>41</sup>Vendimi nr.310, datë 12.11.2015

<sup>42</sup>Vendimi nr. 116, datë 23.04.2015

- përgjegjësinë penale të të pandehurit për faktin penal që i atribuohet.
- c) Parimet e përgjithshme në caktimin dhe individualizimin e dënimit, *si parimi i barazisë para ligjit, parimi i drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe parimi i humanizmit*. Në kuadër të zbatimit të këtyre parimeve, gjyqtari në të gjitha vendimet penale të themelit, përcakton dhe individualizon dënimin për të pandehurin duke iu referuar kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 47 e vijues të Kodit Penal dhe duke analizuar të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese të të pandehurit.
- d) *Parimet themelore të procesit gjyqësor civil të parashikuar në nenet 10, 11, 12, 14, 16 etj. (procesi i rregullt ligjor nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile, barra e provës, kontradiktoriteti, etj.), mbi bazën e të cilave gjykata disponon për bazueshmërinë ose jo të padisë.*

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi interpretimit të ligjit material, zbatimit të praktikës gjyqësore unifikuese, praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, zbatimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës, por jo me të njëjtën shkallë maksimale kujdesi interpretimit të dispozitave procedurale civile, kur ato janë drejtpërdrejt të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes. Në këtë rast të fundit, mungesa e zbrërthimit të normave procedurale nëpërmjet interpretimit, nuk arrin të tregojë lidhshmërinë e tyre me faktet e çështjes.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Mbi mesatare”, duke u pikëzuar me 20 pikë.*

## **1.B. ARSYETIMI LIGJOR**

### **1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Vendimet gjyqësore përfundimtare, të arsyetuara prej gjyqtarit {...}, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdorë gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor”.

### ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore, refruar gjuhës së përdorur në shkrim, janë të qarta dhe të kuptueshme edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton se në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu.

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike. Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i rrallë i termave/shprehjeve në gjuhën latine,<sup>43</sup> por gjithmonë kuptimi i tyre jepet në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra-tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin natyrshëm nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Spikat aftësia e gjyqtarit në drejtim të koncizitetit të përshkrimit të fakteve të çështjes, ruajtjes së rendit kronologjik të tyre, pa përsëritje, çka krijon një panoramë të qartë të konfliktit që ai ka për zgjidhje, apo të fakteve mbi të cilat janë ngritur akuzat në gjykim. Referimi i përmbajtjes së provave është i barazpeshuar dhe po kështu edhe pretendimet e palëve. Nëpërmjet pasqyrimit të këtyre të fundit evidentohen lehtësisht çështjet që shtrohen për zgjidhje, e që gjyqtari duhet t'iu japë përgjigje në vendimin gjyqësor.

### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

<sup>43</sup>Për shembull: “*nullum crimen, nulla poena sine culpa*”, *condicio sine qua non*”, “*in dubio pro reo*” etj.

## **1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Struktura e çdo vendimi është e qëndrueshme nga pikëpamja e organizimit, ndonëse nuk paraqitet e standardizuar, pasi duket që gjyqtari duke qenë në fillim të përvojës së tij është ende në proces të uniformizimit të praktikës së punës. Në disa raste, pjesa arsyetuese paraqitet me tekst unik, ndërsa në disa raste të tjera, arsyetimi organizohet me nënpjesë, të emërtuara me tituj, që kanë nevojë ende të konsolidohen. Kur përdor referenca në ligje apo në jurisprudencën e gjykatave më të larta, referencat janë të qarta me attribute të plota. Ai duhet shmangë referimet me fraza të përgjithshme, të tipit “sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së” (shih dokumentin 1), si dhe në rastin kur përmbajtja e ligjit nuk interpretohet ndryshe nga palët, duhet të shmangë citimin e plotë të tij, për të lehtësuar kuptimin e arsytimit. Një tipar shumë i mirë i tij është hartimi i dispozitivit me paragrafë të numërtuara në mënyrë solide dhe të rregullt, që jo vetëm i jep kuptim të qartë atij, por lehtëson edhe sistemin e referencës”.*

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:***

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Konstatohet se vendimet civile përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile:

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënave lidhur me gjykatën, koha dhe vendi i zhvillimit të gjykimit, palët dhe përfaqësuesit e tyre, objekti dhe baza ligjore e padisë, si dhe kërkimet

përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

*Në pjesën përshkruese-arsyetuese* gjejnë pasqyrim: rrethanat e fakteve të çështjes, siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, parashtrimi në mënyrë të përmbledhur i pretendimeve të palëve, ku gjykata merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionet e tij.

*Pjesa e dispozitivit* është e qartë, koncize, e thjeshtë dhe e kuptueshme, duke bërë të qarta disponimet e gjykatës lidhur me objektin e padisë, si dhe elementët e tjerë të vendimit lidhur me shpenzimet gjyqësore, të drejtën e ankimit, etj. Gjyqtari ndjek një strukturë pothuajse të njëjtë në paraqitjen e vendimeve përfundimtare, e cila është karakteristike e qëndrueshme e gjyqtarit, çka i bën vendimet e tij tepër të qarta dhe të kuptueshme.

Po kështu, konstatohet se vendimet penale përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale:

*Pjesa hyrëse* përmban të gjithë elementët e nevojshëm në lidhje me përcaktimin e gjykatës, përbërjen e trupit gjykues, kohën e zhvillimit të gjykimit, të dhënat e plota të palëve dhe përfaqësuesve të tyre, akuzën e plotë, nenet përkatëse të Kodit Penal, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, në mënyrë të përmbledhur.

*Pjesa përshkruese-arsyetuese* e vendimeve gjithashtu ndjek një strukturë të mirëpërcaktuar, e cila ndiqet pothuajse në çdo rast, të ndarë në paragrafë (edhe pse jo me tituj të përcaktuar si p.sh “rrethanat e faktit”, “ligji i zbatueshëm”, “vlerësimi i gjykatës”), ku nga mënyra e pasqyrimit të tyre në vendim, konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nëndarje. Organizimi i pjesëve të arsyetimit të vendimit ka ndjekur të njëjtën strukturë, duke filluar me paraqitjen e rrethanave procedurale të çështjes, paraqitjen e faktit penal të provuar gjatë gjykimit, përshkrimin e provave të marra gjatë gjykimit, analizën ligjore mbi provat dhe cilësimin juridik të veprës penale, si dhe caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, ku në fund evidentohen edhe disponimet lidhur me kërkesën për shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore.

*Dispozitivi i vendimeve* është i plotë, i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, duke përmbajtur në mënyrë të qartë të gjitha disponimet e gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurve, akuzën përkatëse, nenet respektive të Kodit Penal, llojin dhe masën e dënimit, uljen e dënimit për shkak të gjykimit të shkurtuar kur është aplikuar, kohën e fillimit të llogaritjes së tij, institucionin e vuajtjes së dënimit, disponimin e plotë për shpenzimet procedurale dhe ato gjyqësore, si dhe të drejtën e ankimit. Pjesa urdhëruese e vendimit është e qartë, koncize, e plotë, e lexueshme dhe e kuptueshme, lidhur me të gjithë elementët e disponimit në vendimin përfundimtar, në funksion të qartësisë së tij për palët dhe lexuesin, si dhe të ekzekutimit të tij.

## **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, jo vetëm në aspektin vizual por edhe atë përmbajtësor të dokumentit ligjor. Nga ana tjetër, ndarja në pjesë, sipas përmbajtjes dhe ndarja e tyre në paragrafë të cilët kanë gjatësi mesatare dhe përmbajnë analizën e një elementi të caktuar të arsyetimit, e bën strukturën e vendimit funksionale dhe i jep lehtësi në lexim dhe kuptueshmëri, favorizuar kjo edhe nga natyra jo tepër komplekse e çështjeve të analizuara.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK**

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Në arsyetim, ai përcakton faktin e mosmarrëveshjes dhe tregon provat ku mbështet ai, duke dhënë edhe arsytet përse provat e kundërta apo pretendimet eventuale të palëve mbi provat nuk pranohen. Identifikon qartësisht pretendimet dhe prapësimet e palëve mbi objektin e mosmarrëveshjes dhe i jep përgjigje të arsyetuar atyre. Vendimet e tij janë gjithëpërfshirëse. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Tek vendimet penale, ai ndalet me kujdes tek arsyetimi i caktimit të llojit dhe dënimit penal, duke dhënë edhe shpjegime teorike dhe jurisprudenciale për qëllimin e dënimit penal, por duhet të bëjë një lidhje më të mirë dhe të detajojë rrethanat specifike të rastit, që shqyrton. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se përgjithësisht, gjyqtari paraqet një analizë të strukturuar të fakteve të çështjes, identifikon, citon dhe analizon ligjin e zbatueshëm, e aplikon atë mbi faktet e çështjes dhe parashtron argumentet mbi mënyrën e zbatimit të ligjit, duke lidhur këto argumente me konkluzionet e arritura mbi kërkimet objekt padie, pretendimet e palëve, apo konkluzionin e tij mbi çështjet penale të shqyrtuara.



Kryesisht, në vendimet penale të themelit, gjyqtari i kushton një vëmendje më të posaçme arsytimit të vendimeve, dhënies së argumenteve ligjore të plota lidhur me faktin penal objekt akuze, provueshmërinë e tij, cilësimin ligjor të faktit, si dhe autorësinë e të pandehurit. Në vendimet civile, cilësia e arsytimit dhe niveli i argumentimit logjik janë më të dukshme në disa prej vendimeve, kryesisht në vendimet në lidhje me marrëdhëniet e punës dhe çështjet familjare, ndërsa në vendimet e tjera arsytimi përqendrohet kryesisht në paraqitjen dhe analizën e rrethanave të provuara në gjykim, në raport me kërkimin objekt padie, pa u ndalur në mënyrë të posaçme në dhënien e argumenteve të zgjeruara ligjore mbi mënyrën e aplikimit të ligjit mbi faktet konkrete. Megjithatë, cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik në një pjesë të vendimeve të analizuara, kryesisht disa prej vendimeve civile dhe penale, është e kushtëzuar edhe nga natyra e mosmarrëveshjes apo çështjes penale në shqyrtim, e cila në këto raste ka natyrë të thjeshtë, duke kufizuar nevojën e kryerjes së një analize të zgjeruar ligjore mbi faktet e provuara.

Përgjithësisht, arsytimi i vendimeve paraqitet i plotë dhe i qartë, duke i kushtuar rëndësi argumentimit më të plotë dhe gjithëpërfshirës, veçanërisht në rastet kur ka qenë e nevojshme për shkak të ekzistencës së elementëve të diskutueshëm në raport me faktin penal ose civil objekt shqyrtimi. Në tërësi, arsytimi i vendimeve ndjek përgjithësisht një zhvillim logjik të koncepteve ligjore në aspektin procedural dhe material civil apo penal, duke u ndalur në analizën dhe argumentimin e zgjeruar të tyre vetëm në disa raste, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Pavarësisht natyrës komplekse ose jo të çështjes, gjyqtari ka evidentuar në çdo rast në mënyrë të qartë dhe lehtësisht të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar më pas arsytimin e vendimit, interpretimin e ligjit dhe përjasjen e tij të drejtpërdrejtë me faktin e provuar në gjykim, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

Në disa prej vendimeve të analizuara rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës civile dhe penale, kur kjo rezulton e nevojshme, në shërbim të përcaktimit të natyrës së çështjes ose konkluzioneve të arritura lidhur me të, si p.sh:

- (i) *Marrëdhënies juridike të detyrimit të rrjedhur nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor në përgjithësi dhe asaj nga veprimtaria e rrezikshme në veçanti, duke trajtuar kushtet kumulative për lindjen e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit jashtë kontraktor, duke u ndalur në mënyrë specifike tek elementë të tillë si "faji", "lidhja shkakësore";<sup>44</sup>*
- (ii) *Instituti juridik të shpërblimit të dëmit në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke analizuar në mënyrë të posaçme elementet e kontratës së punës, formën e saj, procedurën dhe afatet e zgjidhjes së kontratës, shkaqet e justifikuar në raport me shkaqet e arsyeshme, pasojave që vijën nga mosrespektimi i dispozitave ligjore nga ana e punëdhënësit;<sup>45</sup>*
- (iii) *Padisë së rivendikimit, duke analizuar elementët që qëndrojnë në themel të saj;<sup>46</sup>*
- (iv) *Instituti të zgjidhjes së martesës, duke analizuar martesën, shkaqet e zgjidhjes së saj, pasojat e zgjidhjes së martesës për bashkëshortët;<sup>47</sup>*
- (v) *analizës së katër elementëve të figurës së veprës penale, në arritjen e konkluzionit mbi përgjegjësinë penale të autorëve. Në të gjitha vendimet penale konstatohet se gjyqtari analizon qëllimin e dënimit*

---

<sup>44</sup>Vendimi nr.304, datë 22.10.2014

<sup>45</sup>Vendimi nr.123, datë 14.04.2016, vendimi nr.41, datë 18.02.2015, vendimi nr.227, datë 28.07.2016

<sup>46</sup>Vendimi nr.279, datë 08.10.2015

<sup>47</sup>Vendimi nr.304, datë 22.10.2014

dhe pasi analizon dispozitat përkatëse materiale mbi individualizimin e dënimit, ndalet në mënyrë të veçantë tek çdo rrethanë lehtësuese apo rënduese për të pandehurit duke individualizuar dënimin për secilin prej tyre. Në një rast, konstatohet se gjyqtari analizon dhe heqjen e së drejtës për të ushtruar funksione publike si dënimi plotësues, që jepet në mënyrë të detyrueshme ndaj personave që kryejnë krime duke shpërdoruar funksionin publik,<sup>48</sup> etj.

Nëse argumentimin logjik të analizës do ta ndanim në dy pjesë, në procesin analitik të të provuarit të fakteve dhe atë logjik se si konceptet, institutet dhe dispozitat ligjore zbatohen në një situatë të caktuar të provuar, i pari mbizotëron në analizën e gjyqtarit. Peshën kryesore në vendimet gjyqësore të analizuara e zë kryesisht procesi analitik i të provuarit të fakteve dhe ai i interpretimit abstrakt të normës materiale. E njëjta shkallë aftësie nuk evidentohet në analizën e zbatimit të ligjit mbi faktet e provuara. Madje në disa raste, konkluzioni vjen menjëherë pas evidentimit të faktit dhe interpretimit abstrakt të elementëve të dispozitës. Kjo mënyrë e të shkruarit dhe të arsyetuarit, jo gjithmonë evidenton nëse faktet konkrete të çështjes janë të asaj natyre, cilësie (kualiteti) dhe të tilla çfarë kërkohet nga dispozitat e ligjit material apo atij procedural, në lidhje të drejtpërdrejtë me konkluzionin e arritur.

## KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi “shumë të lartë” në lidhje me treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”, aftësi të cilat reflektohen në mënyrë më të plotë në disa prej vendimeve të analizuara, kryesisht në vendimet penale të themelit dhe në disa prej vendimeve civile të analizuara, ndërkohë që në pjesën tjetër të tyre analiza është e qartë, por edhe pse nuk reflekton të njëjtën shkallë kujdesi në lidhje me argumentimin logjik se si dispozitat ligjore zbatohen mbi faktet e provuara, kjo duket që ka qenë e kushtëzuar nga natyra jocomplekse e këtyre çështjeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Në tërësi, referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.*

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	95

<sup>48</sup>Vendimi nr.310, datë 12.11.2015

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.*

### 2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

#### 2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...Në 5 dosjet të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati standard apo ligjor (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 4) ndërsa në 1 rast, ky afat është tejkaluar me vetëm 10 ditë (Shih dosjen 5)...”.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar çështjeve të përzgjedhura me short, vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari dhe vendimet të administruar për shkak të ankesave.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari dhe 2 (dy) vendimeve të administruar për shkak të ankesave, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes. Konkretisht, për vendimin nr.131 regj. themeltar, datë vendimi 03.06.2014, me objekt lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, në nenin 510 të K.Pr.Civile parashikohej afati ligjor shqyrtimi brenda 5 ditësh nga dita e paraqitjes të kërkesës në gjykatë. Në mungesë të të dhënave mbi datën e regjistrimit të kërkesës në gjykatë, pasi në vendim referohet vetëm data e vendimit, përlllogaritja e kohëzgjatjes së gjykimit në këtë këndvështrim rezulton e pamundur dhe për pasojë, ky vendim nuk mund të shërbejë si burim vlerësimi për këtë tregues pasi nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar kohëzgjatjen e gjykimit dhe për pasojë, për të vlerësuar nëse ajo është brenda apo jashtë afati ligjor 5 ditor.

## KONKLUSIONI

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi dhe nga dokumentet e përdorura gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka të dhëna të tjera që mund të vlerësohen në drejtim të këtij treguesi, prezumohet se gjyqtari i ka gjykuar të gjitha çështjet për të cilat parashikohet afat ligjor, brenda këtij të fundit, prandaj aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues, pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.*

## 2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari {...} ka qenë në intervale kohore nga 1 muaj (shih dosjen 3) deri në 4 muaj e 10 ditë (shih dosjen 5). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 4 muaj e 10 ditë ka qenë çështje familjare, e përfunduar me vendim themeli zgjidhje martesë (shih dosjen 5). Ne tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 3 muaj e 10 ditë (shih dosjen 2), 3 muaj e 13 ditë (shih dosjen 1) dhe 3 muaj e 14 ditë (shih dosjen 4). Në 5 dosjet të vëzhguara është konstatuar se në 4 raste është respektuar afati standard apo ligjor (shih dosjet 1, 2, 3 dhe 4) ndërsa në 1 rast, ky afat është tejkaluar me vetëm 10 ditë (Shih dosjen 5). Edhe tek 3 dokumentet ligjore, të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, është respektuar afati standard i gjykimit. Konkretisht kohëzgjatja e gjykimit për këto 3 raste ka qenë 4 muaj e 20 ditë (shih dokumentin 1), 4 muaj e 4 ditë (shih dokumentin 2) dhe 1 muaj e 22 ditë (shih dokumentin 3). Rrjedhimisht, gjyqtari {...} ka respektuar procesin e rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së çështjes”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11

(njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short, 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtari, 1 (një)<sup>49</sup> vendim të administruar për shkak të ankesave nga KPK<sup>50</sup> dhe 1 (një) vendim i trajtuar në relacionin e Inspektoratit të ish-KLD për verifikimin e ankesës të paraqitur për zvarritje gjykimi.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se në çështjet e vëzhguara, gjykimi përgjithësisht ka përfunduar brenda standardeve minimale kohore, ku referuar Vendimit nr.261/2 të KLD, duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve, rezulton:

#### Çështje penale të kategorisë krime:

- Dosja 1 - (është caktuar me short në datën 19.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 02.07.2014) Gjykimi ka zgjatur 105 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 2 - (është caktuar me short në datën 09.06.2016 dhe ka përfunduar në datën 19.09.2016) Gjykimi ka zgjatur 102 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 6 - (është caktuar me short në datën 13.11.2014 dhe ka përfunduar në datën 11.12.2014) Gjykimi ka zgjatur 28 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 8 - (është caktuar me short në datën 01.10.2015 dhe ka përfunduar në datën 04.11.2015) Gjykimi ka zgjatur 34 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Dosja 10 - (është caktuar me short në datën 17.06.2016 dhe ka përfunduar në datën 22.09.2016) Gjykimi ka zgjatur 97 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Vendimi 1 - (është regjistruar në datën 03.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 23.04.2015) Çështja ka përfunduar për 141 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Vendimi 2 - (është regjistruar në datën 08.07.2015 dhe ka përfunduar në datën 12.11.2015) Çështja ka përfunduar për 127 ditë, **brenda afatit** 9 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime);
- Në çështjen penale nr. (52104-00379-33-2014) 245/9 regjistri, të verifikuar për shkak të ankesave nga ish-KLD, sipas të dhënave në relacionin e Inspektoratit të KLD të datës 29.03.2018, rezulton se data e regjistrimit është 24.07.2014 dhe data e përfundimit të çështjes 22.07.2015. Çështja ka përfunduar për 363 ditë, ose 11 muaj e 28 ditë, pra **brenda afatit** 12 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime),<sup>51</sup> në kusht kur i pandehuri akuzohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 78 i K.Penal, me marzh dënimi nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet burgim.

---

<sup>49</sup>Duke përjashtuar vendimin nr. 131 regj. them. datë vendimi 0306.2014, me objekt “Lëshimin e urdhrin të ekzekutimit”

<sup>50</sup>Nuk përfshihen çështja me afat ligjor gjykim, konkretisht vendimi nr.150, datë 31.05.2016.

<sup>51</sup>Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “a. Gjykimet penale në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 4 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 12 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm”.

### Çështje familjare:

- Dosja 5 - (është caktuar me short në datën 12.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 22.10.2014) Gjykimi ka zgjatur 132 ditë, **tej afatit** 4 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet familjare;

### Çështje civile:

- Vendimi 3 - (është regjistruar në datën 22.02.2016 dhe ka përfunduar në datën 14.04.2016) Gjykimi ka zgjatur 51 ditë, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 3 - (është caktuar me short në datën 04.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 05.03.2014) Gjykimi ka zgjatur 29 ditë, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 4 - (është caktuar me short në datën 26.02.2015 dhe ka përfunduar në datën 10.06.2015) Gjykimi ka zgjatur 104 ditë, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 7 - (është caktuar me short në datën 20.05.2014 dhe ka përfunduar në datën 15.07.2014) Gjykimi ka zgjatur 56 ditë, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 9 - (është caktuar me short në datën 04.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 18.02.2015) Gjykimi ka zgjatur 76 ditë, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Dosja 11 - (është caktuar me short në datën 05.05.2016 dhe ka përfunduar në datën 28.07.2016) Gjykimi ka zgjatur 84 ditë, pra **brenda afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile;
- Vendimi i administruar për shkak të ankesave - (është regjistruar në datën 17.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 08.10.2015) Gjykimi ka zgjatur 448 ditë, pra **tej afatit** 6 mujor të standardit minimal kohor për gjykimet civile.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore (duke përfshirë këtu edhe vendimet që janë verifikuar për shkak të ankesave), sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se jo të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, sipas vendimit 261/2 të ish KLD, pasi 2 (dy) prej tyre kanë përfunduar tej afatit standard minimal kohor të përcaktuar për secilën kategori. Pra, në total 12.5% të çështjeve janë jashtë afatit standard minimal kohor.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për 87.5% të çështjeve të analizuara. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja matematikore prej 12.5% përkon me nivelin e vlerësimit 4 (katër) pikë. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në kontekst të sa më sipër arsyetohet u analizuan të dhënat me qëllim shmangien e përfundimeve që nuk janë përgjegjësi e gjyqtari, nga e cila rezultoi se:

1. Çështja civile nr. regjistri 289 (21001-00373-33-2014), datë 11.06.2014 me palë paditëse B.L., të paditur A.L., me objekt "Zgjidhje martesë", përfunduar me vendimin nr. 304, datë 22.10.2014. Referuar të dhënave të vendimit rezultoi se çështja mban si datë regjistrimi 11.06.2014 dhe datë përfundimi 22.10.2014, duke përfunduar brenda një afati prej 132 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në vendimin nr.261/2 të KLD, për gjykimet familjare. Afati tejkalimit të çështjes nga standardi minimal kohor është vetëm 12 ditë, duke pasur parasysh këtu se vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtari në muajin gusht

(30 ditë).<sup>52</sup> Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudha kur gjyqtari ka qenë me leje vjetore, atëherë kjo çështje do të kishit përfunduar për 102 ditë, pra brenda standardeve minimale kohor.

2. Ndërkohë në lidhje me vendimin nr.279, datë 08.10.2015, me palë paditëse D.K., të paditur L.K., me objekt "Lirimin dhe dorëzimin e sendit", të administruar për shkak të ankesave nga ana e KPK, për të cilën është konkluduar se nuk janë konstatuar shkelje procedurale, etike apo mangësi profesionale nga ana e subjektit të rivlerësimit, kjo çështje nuk mund të konsiderohet në afat pasi pavarësisht kompleksitetit të saj, tejkalimi i afatit me 268 ditë apo me rreth 9 muaj nuk e justifikon atë.

Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtohet çështja e analizuar më sipër, atëherë do të rezultonte se nga 16 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, vetëm 1 (një) prej tyre ka përfunduar tej afatit standard minimal kohor, ose rreth **6.25% janë gjykuar jashtë standardit** minimal kohor në fuqi.

## **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 16 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, vetëm njëra prej tyre, ka përfunduar tej afatit prej 6 muajsh. Për sa më sipër, duke iu referuar në tërësi kohëzgjatjes së gjykimit për 16 çështjet për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, çështja e përfunduar jashtë afatit zë vetëm 6.25% të tyre, prandaj gjyqtari vlerësohet për këtë tregues me pikët maksimale.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin "Plotësimi i standardeve minimale kohore", gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal, është 6.25%.*

## **2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:***

<sup>52</sup>Në nenin 24 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" parashikohet se "2. Gjyqtari përfiton leje të pagueshme vjetore prej 30 ditësh kalendarike. Leja vjetore bëhet në muajin gusht..."

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetën) çështjeve të përzgjedhura me short, 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, 1 (një) vendim të administruar për shkak të ankesave dhe 1 (një) vendim i trajtuar në relacionin e Inspektoratit të ish-KLD, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.<sup>53</sup>

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (nga 16 çështjet e marra në analizë, nga të cilat 1 çështje familjare, 8 çështje penale themeli dhe 7 çështje civile), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 8 (tetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “Penale krime”, rezulton të jetë 125 ditë, ose 3 muaj e 5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 9 muaj për gjykimin e çështjeve penale të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 7 (shtatë) çështjet në kategorinë e çështjeve “Civile themeli”, rezulton të jetë 121 ditë, ose 4 muaj, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Shkallës së Parë.
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtarë”, rezulton të jetë 132 ditë, ose 4 muaj e 12 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor prej 4 (katër) muaj për gjykimin e çështjeve familjare në Gjykatën e Shkallës së Parë. Sikurse u analizua edhe në treguesin e mësipërm, në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjes rezulton të ketë ndikuar kryerje e pushimeve vjetor nga ana e gjyqtarit, duke zbritur nga kohëzgjatja e gjykimit këtë periudhë, rezulton se mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për këtë kategori çështjes është 102 ditë, pra më shkurtër se standardi minimal kohor.

## KONKLUZIONI

Referuar si më sipër, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjithë kategoritë e çështjeve, tregues i cili, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzohet me 5 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, për treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje”, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë duke qenë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjithë kategoritë e çështjeve.*

<sup>53</sup>Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: “Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi”.



## 2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Subjekti rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit ka ushtruar detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, e cila nuk ka qenë e organizuar në seksione. Ai ka deklaruar se gjatë periudhës së rivlerësimit i janë caktuar 1328 çështje, ka përfunduar 1241 çështje dhe ka mbartur 53 çështje. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të të dhëna, është 93.4%”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, për efekte të organizimit të shortit për përzgjedhje, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, gjyqtari {...} ka përfunduar 1236 çështje nga të cilat 304 penale themeli, 357 civile themeli, 28 familjare (urdhra mbrojtje), 236 kërkesa civile, 198 kërkesa në fazën e hetimit paraprak (masa sigurimi) dhe 113 kërkesa penale. Por sipas dosjes së rivlerësimit, gjyqtari ka filluar të ushtrojë detyrën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër në fund të muajit janar të vitit 2014. Kështu që të dhënat statistikore si më sipër i përkasin periudhës 24.01.2014-08.10.2016 (2 vjet e 9 muaj).

Referuar tabelave statistikore për periudhën 24.01.2014- 08.10.2016 rezultojnë të dhënat e mëposhtme për kategori çështjesh për çdo vit kalendarik :

- (i) Viti 2014 (11 muaj): gjithsej 225 çështje themeli, ose rreth 12.5% më shumë se standardi i miratuar;
- (ii) Viti 2015: gjithsej 287 çështje themeli, ose rreth 43.5% më shumë se standardi i miratuar;
- (iii) Viti 2016 (10 muaj): gjithsej 177 çështje themeli, ose rreth 6% më shumë se standardi i miratuar duke llogaritur për periudhën 10 mujore.

Për aspektin sasior sipas pikës 3, germa “g” të vendimit të KLD, gjyqtari i gjykatës së shkallës parë që nuk është i organizuar me seksione, si relator gjykon brenda një viti kalendarik jo më pak se 200 çështje, penale (krime dhe kundërvajtje penale) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare, i llogaritur në periudhë 3 vjeçare jo më pak se 600 çështje themeli.

Referuar të dhënave në shkresën nr. 412/1 prot., datë 20.01.20177, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, bashkëlidhur Formularit të vetëvlerësimit, shënohen të dhënat statistikore të për të gjithë periudhën e vlerësimit, pa u ndarë në vitet kalendarike, ku rezulton t'i jenë caktuar në total 1328 çështje dhe ka përfunduar 1241 çështje, duke mbartur për vitin 2016, 53 çështje.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabela me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, si dhe për kategoritë e çështjeve të gjykuara respektivisht brenda të njëjtit vit kalendarik, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe, për pasojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 93.4% i përcaktuar në faqen 22 të raportit.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 93.4%. Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 8 pikë. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”* Bazuar në këtë parashikim dhe në analizën statistikore si më sipër, rezulton se gjyqtari ka tejkuluar standardin minimal të ngarkesës me 12, 43.5 dhe 6%, prandaj nuk justifikohet një shkallë më e lartë pikëzimi. Në të njëjtin konkluzion arrihet edhe nëse tejkalimi i standardit minimal sasior do të llogaritej për një periudhë 3/vjeçare, pasi referuar të dhënave statistikore ka rezultuar se gjyqtari ka një mesatare gjykimi prej 230 çështje në vit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “Mbi 93-99%”, duke u pikëzuar ky tregues me 8 pikë.*

## **2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR**

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari {...}, i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore. Në 4 raste, arsyetimi i vendimeve është kryer brenda afateve ligjore dhe konkretisht për 5 ditë nga shpallja (shih dosjet 1 dhe 2), për 7 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 9 ditë nga shpallja (shih dosjen 5). Ndërsa në 1 rast, vendimi civil është arsyetuar për 15 ditë, duke tejkaluar me 5 ditë afatin ligjor (shih dosjen 3)”*.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 10 (dhjetë) ditor, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë, kur palët ishin prezent, fillonte nga dita e shpalljes së vendimit. Ndërsa referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë (neni 308 paragrafi 2), me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar të vendimit me 5 ditë. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 10 ditor i ankimit ndaj vendimit penal të gjykatës së shkallës së parë.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

- a) Dosja 1 (*penale themeli*), që i përket vendimit me nr.162, datë 02.07.2014 është dorëzuar në datën 08.07.2014 - (6 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- b) Dosja 2 (*penale themeli*), që i përket vendimit me nr.199, datë 19.09.2016 është dorëzuar në datën 26.09.2016 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- c) Dosja 3 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.68, datë 05.03.2014 është dorëzuar në datën 20.03.2015 - (15 ditë), tej afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- d) Dosja 4 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.176, datë 10.06.2015 është dorëzuar në datën 17.06.2015 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- e) Dosja 5 (*çështje familjare*), që i përket vendimit me nr.304, datë 22.10.2014 është dorëzuar në datën 31.10.2014 - (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 13.04.2023, rezulton se:

- f) Dosja 6 (*çështje penale*), që i përket vendimit me nr.289, datë 11.12.2014 është dorëzuar në datën 19.12.2014 - (8 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- g) Dosja 7 (*civile themeli*), që i përket vendimit me nr.229, datë 15.07.2014 është dorëzuar në datën 25.07.2014 - (10 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- h) Dosja 8 (*çështje penale*), që i përket vendimit me nr.296, datë 04.11.2015 është dorëzuar në datën 11.11.2015 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- i) Dosja 9 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr.41, datë 18.02.2015 është dorëzuar në datën 17.03.2015 - (27 ditë), jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile;
- j) Dosja 10 (*çështje penale*), që i përket vendimit me nr.200, datë 22.09.2016 është dorëzuar në datën 29.09.2016 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016 referuar edhe interpretimit të sipërcituar;
- k) Dosja 11 (*çështje civile*), që i përket vendimit me nr.227, datë 28.07.2016 është dorëzuar në datën 04.08.2016 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308 të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për çështjet e kategorisë “Penale” është 7 ditë; për kategorinë “Civile themeli” është 13.2 ditë dhe për kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtare” është 9 ditë.

#### **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”, pasi për një nga kategoritë e çështjeve afati procedural rezulton të jetë tejkaluar me 3.2 ditë. Ky tejkallim konsiderohet i papërfillshëm, duke pasur në konsideratë se nuk tejkalohet afati 15 ditor i të drejtës së ankimi dhe sipas Metodologjisë justifikon zbatimin e një niveli më të lartë pikëzimi bazuar në koeficientin 20%, me pasojë pikëzimin me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” duhet të konsiderohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE**

### **2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHITJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JOPRODUKTIVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 7 seanca (shih dosjet 1 dhe 4), me 4 seanca (shih dosjen 2), me 2 seanca (shih dosjen 3) dhe me 5 seanca (shih dosjen 5). Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar 25 seanca, nga të cilat 10 kanë qenë produktive. Pengesë në 15 seanca joproduktive ka qenë pasaktësia e gjeneraliteteve të të pandehurit (3 seanca), mungesa e prokurorit (2 seanca), kërkesa e prokurorit për t’u njohur me aktet e çështjes (1 seanca), mungesa e gjyqtarit (2 seanca) dhe shpallja e datës së seancës ditë pushimi zyrtar (1 seancë), kërkesa e të paditurit për shtyrjen e seancës (1 seancë), kërkesa e të paditurit për të studiuar aktet ( 1 seancë), kërkesa e të paditurit për t’u njohur me aktin e ekspertimit (1 seancë), fillimi me vonesë i seancës gjyqësore (1 seancë) dhe mosparaqitja e palëve në procesin civil (2 seanca).....Në vijim, ai i ka kushtuar vëmendje caktimit të seancave, duke respektuar afatet në procesin penal, si dhe duke i caktuar në distanca të arsyeshme në procesin civil. Në një sat është konstatuar se seanca civile është caktuar pas 2 muaj e 9 ditë, që nuk justifikohet as me lejen vjetore (shih dosjen 5)”*.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 15 (pesëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura për vlerësim, të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtarë për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1 - që i përket çështjes penale, me nr.121 regjistri, datë regjistrimi 19.03.2014, përfunduar me vendimin nr.162, datë 02.07.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 7 (shtatë) seanca gjyqësore, nga të cilat 5 (pesë) seanca kanë rezultuar joproduktive, 2 për shkak të mos paraqitjes së prokurorit dhe 3 për mosparaqitje të të pandehurit.
- Dosja 2 - që i përket çështjes penale, me nr.196 regjistri, datë regjistrimi 03.06.2016, përfunduar me vendimin nr.199, datë 19.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat 3 (tre) seanca kanë rezultuar joproduktive, duke u shtyrë 1 për mosparaqitjen e prokurorit, 1 për mosformim të trupit gjykues (gjyqtari nuk është paraqitur për arsye shëndetësore), si dhe 1 për shkak të pushimit zyrtar të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave pas datës të caktimit të seancës.

- Dosja 3 - që i përket çështjes civile, me nr.128 regjistri, datë regjistrimi 22.01.2014, përfunduar me vendimin nr.68, datë 05.03.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive duke qenë se çështja është zgjidhur me vendim përfundimtar.
- Dosja 4 - që i përket çështjes civile, me nr.146 regjistri, datë regjistrimi 25.02.2015, përfunduar me vendimin nr.176, datë 10.06.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 seancë ka rezultuar joproduktive, duke u shtyrë për shkak të çeljes me vonesë të seancës gjyqësore (*zgjatja e seancës paraardhëse tej orarit të planifikuar*). Të gjitha seancat gjyqësore e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale të tilla si: lënien kohë ekspertit për të përgatitur aktin e ekspertimit, lënien kohë palëve për tu njohur me aktin e ekspertimit.
- Dosja 5-që i përket çështjes familjare, me nr.289 regjistri, datë regjistrimi 11.06.2014, përfunduar me vendimin nr.304, datë 22.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive duke qenë se çështja është zgjidhur me vendim përfundimtar.

➤ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 - që i përket çështjes penale, me nr.316 (58345-00565-33-14) regjistri, datë regjistrimi 12.11.2014, përfunduar me vendimin nr.289, datë 11.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive duke qenë se çështja është zgjidhur me vendim përfundimtar.
- Dosja 7 - që i përket çështjes civile, me nr.260 (21240-00267-33-2014) regjistri, datë regjistrimi 20.05.2014, përfunduar me vendimin nr.229, datë 15.07..2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive.
- Dosja 8 - që i përket çështjes penale, me nr.316 (59106-00456-33-2014) regjistri, datë regjistrimi 25.09.2015, përfunduar me vendimin nr.296, datë 04.11.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nuk ka seanca joproduktive.
- Dosja 9 - që i përket çështjes civile, me nr.469 (21243-00675-33-14) regjistri, datë regjistrimi 01.12.2014, përfunduar me vendimin nr.41, datë 18.02.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive duke qenë se çështja është zgjidhur me vendim përfundimtar.
- Dosja 10 - që i përket çështjes penale, me nr.205 (53204-00292-33-16) regjistri, datë regjistrimi 16.06.2016, përfunduar me vendimin nr.200, datë 22.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 seanca kanë rezultuar joproduktive, për shkak të mosformimit të trupit gjykues (gjyqtari nuk është paraqitur për arsye shëndetësore), si dhe 1 për shkak të pushimit zyrtar të caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave pas datës të caktimit të seancës.
- Dosja 11-që i përket çështjes civile, me nr.244 (21234-00215-33-2016) regjistri, datë regjistrimi 03.05.2016, përfunduar me vendimin nr.227, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 ka rezultuar joproduktive, për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të palës së paditur.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (*penale themeli dhe civile themeli*) varion nga 1 deri në 7 seanca gjyqësore. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 2 seanca gjyqësore në çështjet civile me

palë kundërshtare (*duke përjashtuar seancat përgatitore*), 3.4 seanca gjyqësore në çështje penale themeli dhe 1 seancë gjyqësore në çështjet familjare (*duke përjashtuar seanca e pajtimit*). **Në total numri mesatar i seancave është 2.5 seanca për të gjitha kategoritë e çështjeve.**

Nga vëzhgimi i 11 dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile dhe penale themeli me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar përgjithësisht ligjin procedural civil dhe penal (*nenin 158/a dhe 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe neni 333 e vijues dhe 342/2 të K.Pr.Penale*). Në çështjet penale data e seancës dhe aktet e njoftimit, respektojnë afatet 10 ditore të përcaktuara në nenin 333 të K.Pr.Penale, me përjashtim të çështjes penale të përfunduar me vendimin nr.162, datë 02.07.2014, ku vendimi për caktimin e seancës gjyqësore është marrë pas 15 ditësh pas caktimit të çështjes me short (19.03.2014-03.04.2014).

Përgjithësisht shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: *përsëritjen e njoftimit për palën e paditur, kryerja e aktit të ekspertimit, lënien kohë palëve për tu njohur me aktin e ekspertimit, lënien kohë palëve për të përgatitur konkluzionet përfundimtare, për shpalljen e arsyetuar të vendimit, etj.* Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale, me përjashtim të dy rasteve ku konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës, për shkak të lejes vjetore në muajin gusht.<sup>54</sup> Po kështu, edhe në çështjet civile konstatohet se gjyqtari cakton përgjithësisht seanca të afërta në kohë nga njëra – tjetra jo më shumë se 1 muaj larg. Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit së çështjes.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 2.5 seanca, si dhe gjithashtu gjyqtari ka treguar kujdes duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproductive.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i ulët se 3 për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare dhe faktit se shkalla e kujdesit të

---

<sup>54</sup>Shih dosjet me nr. 200 vendimi, datë 22.09.2016 dhe nr.199, datë 19.09.2016

treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave gjyqësore joproductive dhe administrimin e procesit gjyqësor në tërësi është e lartë, gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.*

## **2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dy çështje civile për njohjen e vërtetësisë së dokumentacionit dhe për shpërbelimin e dëmit jashtëkontraktor, ai ka kryer rregullisht veprimet përgatitore (shih dosjet 3 dhe 4). Në një çështje familjare për zgjidhje martesë, ai ka kryer veprimet e pajtimit, por procedura nuk ka qenë rigorozë: ai ka proceduar me njoftimin e të paditurit me fletëthirrjes në banesë në Shqipëri, teksa në vendimin përfundimtar shënon se shkak i zgjidhjes së martesës është përfundimi i bashkëjetesës nga largimi jashtë shtetit i të paditurit; ai ka shtyrë veprimet e pajtimit ku nuk është paraqitur i padituri, me qëllim rithirrjen e tij, por ky veprim ka qenë formalist, pasi gjyqtari ka vijuar menjëherë më pas me zhvillimin e seancës gjyqësore pa ndërprerje dhe rrjedhimisht, nuk është marrë vendim për gjykimin në mungesë të të paditurit. (shih dosjen 5).... Një tipar i mirë i punës së tij është zhvillimi i seancave në sallë gjykimi dhe dokumentimi i tyre me regjistrim audio, në funksion të transparencës dhe të solemnitetit.. Ai nuk ka patur vonesa në fillimin e seanca gjyqësore, me përjashtim të rasteve, kur merrte pjesë në gjykime të tjera (shih dosjet 2, 3 dhe 4), madje në një rast, vonesa ka shkaktuar dështimin e seancës (shih dosjen 4). Për pasojë, ai duhet të përmirësojë aftësitë e tij, planifikuese, me qëllim shmangien e rasteve të vonesave të fillimit të seancës gjyqësore për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarit në gjykime të tjera. Në procesin penal duhet të respektojë afatin 10 ditor të nxjerrjes së urdhrin për caktimin e seancës së parë sipas përcakton neni 333 pika 1 i K.Pr.Penale (shih dosjet 1 dhe 2) Në vijim, ai i ka kushtuar vëmendje caktimit të seancave, duke respektuar afatet në procesin penal, si dhe duke i caktuar në distanca të arsyeshme në procesin civil. Në një sat është konstatuar se seanca civile është caktuar pas 2 muaj e 9 ditë, që nuk justifikohet as me lejen vjetore (shih dosjen 5). Gjyqtari {...} zhvillon në*



*mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejta dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar. Në të gjitha rastet, disponon me vendime të ndërmjetme e me shkak ligjor për çdo veprim procedural të kryer gjatë gjykimit”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :***

Nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, të gjitha i përkasin kategorive të çështjeve penale dhe civile me palë kundërshtare.

Gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe vendim për caktimin e seancës gjyqësore brenda 3 ose deri në 15 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Thuhet në përgjithësi pasi në një rast gjyqtari vendimin për caktimin e seancës gjyqësore, e ka marrë jashtë afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 333 të K.Pr.Penale. Seancat përgatitore dhe ato gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, duke u mbajtur me sistemin e regjistrimit audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

*Në çështjet civile-* Përgjithësisht, rezulton që seancat gjyqësore të jenë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale sipas dispozitave të K.Pr.Civile dhe duke pasqyruar veprimet e kryera për verifikimin e paraqitjes së palëve dhe përfaqësuesve të tyre, relativitetin e akteve të njoftimit dhe marrjen ose jo dijeni nga palët që nuk janë paraqitur, disponimin me vendim të ndërmjetëm për zhvillimin e gjykimit në mungesë në rastet e mosparaqitjes së palëve pa shkaqe të përligjura, shpalljen e trupit gjykues, dhënien e fjalës palëve për kërkesa paraprake, disponimin me vendim për kërkesat paraprake të palëve në rastet kur paraqiten kërkesa të tilla, deklarimin të hapur të shqyrtimit gjyqësor; dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave, administrimin e provave, drejtimin dhe orientimin e debatit mbi provat, si dhe mbi elementë proceduralë të zhvillimit të gjykimit, dhënien e fjalës palëve lidhur me vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor pas zhvillimit të debatit mbi provat, deklarimin e mbyllur të shqyrtimit gjyqësor, dhënien e fjalës palëve për paraqitjen e diskutimit përfundimtar, tërheqjen e gjykatës për marrjen e vendimit dhe shpalljen e vendimit përfundimtar.

Konstatimi “përgjithësisht” përdoret pasi në një rast, evidentohet se gjyqtari pas ezaurimit të veprimeve përgatitore dhe kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, ka vijuar gjykimin pa njoftuar palën e paditur për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe datën e kësaj të fundit, duke vijuar gjykimin në mungesë, për shkak të deklarimit të mungesës në seancë përgatitore, edhe pse në referim të neneve 175 dhe 179 të K.Pr.Civile gjykata ka detyrimin për të njoftuar palët për seancën gjyqësore dhe të hetojë shkaqet e mosparaqitjes së tyre.<sup>55</sup> Nga ana tjetër në këtë rast nuk rezulton që vendimi i ndërmjetëm i marrë në seancë përgatitore të jetë i arsyetuar pse gjyqtari nuk ka urdhëruar njoftimin për seancën e parë gjyqësore të palës së paditur në mungesë.

---

<sup>55</sup>Shih dosjen që i përket vendimit nr.41, datë 18.02.2015

Ndërsa në çështjen familjare me objekt “Zgjidhje martese” rezulton se me vendimin për “Kalimin e çështjes në seancë gjyqësore”, datë 19.06.2014 gjyqtari ka caktuar seancën gjyqësore në datën 09.07.2014. Dy seancat e para të zhvilluara në datat 11.09.2014 dhe 02.10.2014 (*seanca e planifikuar për në datën 09.07.2014 nuk u zhvilluar për mosformim të trupit gjykues*), edhe pse në procesverbal evidentohen se janë seanca gjyqësore, nga përmbajtja e tyre dhe shkak i shtyrjes së seancave rezulton të jenë zhvilluar në kuadër të përpjekjeve të gjykatës për pajtim, konfrom neni 134 të K.Familjes. Edhe pse nga përmbajtja e shënimeve të bëra në fletëthirrjen drejtuar të paditurit në adresën e tij sipas akteve të gjendjec civile (seanca e dt. 11.09.2014) rezulton shënimi “nuk ndodhet në shtëpi”, gjyqtari nuk rezulton të ketë proceduar me njoftimin nëpërmjet afishimit publik parashikuar nga neni 133 i K.Pr.Civile në fuqi në kohën e gjykimit. Për seancën e parë efektive të pajtimit, i padituri rezulton i njoftuar nëpërmjet marrjes përsipër të njoftimit nga vëllai i njoftuar me telefon celular, i cili edhe pse ka deklaruar se nuk ka folur prej kohësh me të vëllanë ka marrë përsipër ta njoftojë. Ky njoftim i referohet seancës së parë të pajtimit të dt. 02.10.2014. Në vijim gjyqtari ka marrë vendimin për caktimin e një seance të dytë pajtimi, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit për palën e paditur, por edhe pse njoftimi është kthyer përsëri me shënimin “nuk ndodhet në shtëpi” i firmosur nga një dëshmitar, që nga shënimi duket se është i vëllai i të paditurit, gjyqtari ka vazhduar seancën përgatitore e në vijim edhe atë gjyqësore në mungesë të palës së paditur, edhe pse akti i njoftimit nuk përmban të gjithë elementët e kërkuar nga neni 131 paragraf 4 i K.Pr.Civile.<sup>56</sup>

*Në çështjet penale-* Seancat gjyqësore janë zhvilluar në mënyrë korrekte, duke ndjekur ecurinë procedurale të gjykimit penal sipas parashikimeve të neneve 405 e vijues të K.Pr.Penale (në rastet kur është proceduar me gjykim të shkurtuar). Gjatë zhvillimit të gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për relatimin e verifikimit të paraqitjes së palëve e të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, të shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (gjykim i shkurtuar), administrimin e provave, dhënien e fjalës palëve për diskutimin përfundimtar, si dhe shpalljen e vendimit përfundimtar. Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa deri në 15 minuta që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës e përgatitjen e sallës së gjykimit, në kushtet kur gjykimet zhvillohen njëri pas tjetrit, pa diferenca kohore. Megjithatë konstatohet se në disa raste (3 seanca) seanca ka filluar me më shumë se 22 minuta deri në 73 minuta vonesë nga ora e planifikuar. Në tërësi, pavarësisht fillimit me vonesë të disa prej seancave gjyqësore, të cilat rezultojnë në një përqindje të vogël në raport me seancat e analizuara (*11% e seancave rezultojnë të filluara me vonesë*) ku vetëm në një rast ka sjellë pasojë në produktivitetin

---

<sup>56</sup> Shih dosjen që i përket vendimit nr. 304, datë 22.10.2014

e gjykimit të çështjes.<sup>57</sup> Shkak i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relatimit të gjyqtarit lidhet me pjesëmarrjen e tij në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë aftësie “mbi mesataren” në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, aftësi të cilat reflektohen në mënyrë më të plotë në disa prej çështjeve të analizuara, duke ndjekur me korrektësi planifikimin, mbikëqyrjen, zhvillimin dhe dokumentimin e veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil në seancat gjyqësore të zhvilluara, ndërkohë që në dy dosjet e analizuara më lart gjyqtari nuk reflekton të njëjtën shkallë kujdesi lidhur me njoftimin efektiv të palës së paditur për pjesëmarrje në seancë pajtimi apo zhvillimin e seancës gjyqësore. Gjyqtari nuk ka mbikëqyrur në çdo rast plotësinë dhe qartësinë e njoftimit për palët që iu drejtohen, pavarësisht masave të tjera efektive të marra prej tij për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Përfundimi i gjykimit në një kohë sa më të shpejtë, nuk justifikon shmangien e detyrimeve procedurale për njoftimin e rregullt të palëve në proceset civile.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Mbi mesatare” duke e pikëzuar me 16 pikë.*

## **2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE**

### **2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short përgjithësisht është konstatuar se gjyqtari ka aftësi për të administruar dosjet. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtari ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës

<sup>57</sup>Seanca e datës 27.05.2015, në çështjen civile me nr.176 vendimi, datë 10.06.2015, e cila ka rezultuar joproductive për shkak të fillimit me vonesë të seancës. Fillimi me vonesë lidhet për shkak të zgjatjes tej orarit të planifikuar të seancës paraardhëse në një çështje penale.

*përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtari, është mbajtur procesverbal administrativ, me përjashtim të 1 seancë, shkaku i dështimit të të cilës është relatuar në seancën vijuese (shih dosjen 2). Në dosje gjenden të gjithat aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar si kërkesëpapia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjes, provat gjer tek vendimi përfundimtar. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Lidhur me procesverbalin gjyqësor është konstatuar se shënohet saktë ora e fillimit dhe e përfundimit të seancës. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit. Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara janë inventarizuar rregullisht aktet procedurale”.*

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se dosjet janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e dosjeve ndjek kryesisht të njëjtën linjë në të 11 dosjet e vëzhguara, duke grupuar aktet sipas kategorisë së tyre.

Renditja e dosjes në çështjen penale fillon me vendimin e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore, vijon me aktin e shortit, njoftimet në rend kronologjik, diskutimet me shkrim të palëve, procesverbalet e seancave sipas datave dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Renditja e dosjes në çështjet civile fillon me vendimin e gjyqtarit për caktimin e seancës përgatitore, vijon me aktin e shortit, padinë dhe provat e paraqitura nga palët, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalet e seancave përgatitore, kërkesat dhe parashtrimet me shkrim të palëve gjatë gjykimit, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave. Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

## **KONKLUZIONI**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie shumë të lartë të aftësisë në lidhje me këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 5 pikë.

## 2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Në dosje gjenden të gjithat aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar si kërkesëpadia apo kërkesa penale për gjykim, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjes, provat gjer tek vendimi përfundimtar. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale”.*

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seancë përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve, si dhe vendimi përfundimtar) si dhe aktet e paraqitura nga palët (aktet e përfaqësimit të palëve, provat e administruara në të cilën përfshihet edhe akti i ekspertimit nëse është lejuar marrja e provës me ekspert, diskutimet përfundimtare të palëve, etj.).

Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, me përjashtim të çështjes civile Nr. 128 Regj them dt.regj 22.01.2014, që i përket vendimit nr. 68 dt.05.03.2014, ku konstatohet mungesa e vendimit të zbardhur të refuzimit të marrjes pjesë në gjykim të personit të tretë. Nga përmbajtja e vendimit dhe procesverbalit të seancës përgatitore konstatohet se gjyqtari ka refuzuar pjesëmarrjen në gjykim të personit të tretë të thirrur nga pala paditëse në padi, por nuk rezulton të jetë zbardhur i arsytuar dhe të jetë pjesë e akteve të dosjes vendimi i refuzimit të marrjes pjesë të personit të tretë, ndaj të cilit në zbatim të nenit 194 parag 2 të K.Pr.Civile në fuqi në kohën e gjykimit, lejohet ankim i veçantë.

### KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie “Mbi mesataren” në lidhje me këtë tregues.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Mbi mesataren”, duke u pikëzuar me 8 pikë.*

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	92

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

#### 3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Gjyqtari {...} ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.06.2007 dhe titullin “Magjistratë gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2011. Pas studimeve, në datën 23.01.2014, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, ku vazhdon dhe aktualisht. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit {...} (shi të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhënat negative për këtë aspekt”.*

#### 3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionin e hartuar nga Inspektorati i KLD rezulton se objekt i verifikimit dhe analizës ka qenë zvarritja e gjykimit të çështjes penale me nr. (52104-00379-33-2014) 245/9 akti, datë regjistrimi 24.07.2014, të përfunduar me vendimin e datës 22.07.2015. Nuk konstatohet në relacionin e hartuara nga Inspektorati i KLD, të jenë evidentuar elementë që të dëshmojnë shfaqje e sjellje që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë

vetëpërbajtjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 579, datë 28.10.2022, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit profesional, janë gjetur të pabazuara.

#### **KONKLuzioni**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.*

### **3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.

#### **3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
  - Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
  - Të dhënat për masa disiplinore;
  - Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :*

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj gjyqtarit {...}, në periudhën e vlerësimit, të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} është paraqitur vetëm 1 (një) ankesë në Inspektoratin e ish KLD.<sup>58</sup> Në materialet për verifikimin e ankesës rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se “42. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në Aneksin 1, që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e të cilave mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës. 43. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat, duke filluar nga viti 2011, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti, pranë ILDKPKI-së, nga ku ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv,....”.<sup>59</sup>

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr.579, datë 28.10.2022, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: “...në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit {...} arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklarime të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar”.<sup>60</sup>

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

## **KONKLuzioni**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

<sup>58</sup>Sikurse pasqyrohet në pjesën e dytë të këtij Projektraporti, të titulluar “Burimet e vlerësimit”

<sup>59</sup> Në faqen 12 të vendimit

<sup>60</sup>Në faqen 14 të vendimit



*Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.*

### **3.C PAANËSIA E GJYQTARIT**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vetë gjyqtarin {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, me përjashtim të pasaktësive procedurale të evidentuara tek Aftësitë Organizative, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme”.*

#### **3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar akteve burim vlerësimi, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

### **3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Për gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve”*.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ), si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” nuk ka asnjë të tillë, prandaj pikëzimi është me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

#### **4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

##### **4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari {...} komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikues me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.

##### **4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

#### **KONKLUZIONI**

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

#### **4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

**Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...}, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Gjyqtari ka patur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore, për shkak të pjesëmarrjes së tij në gjykime të tjera (shih dosjet 2, 3 dhe 4), madje në një rast vonesa i ka shkaktuar dështimin e seancës (shih dosjen 4). Megjithatë, duket se këto të dhëna lidhen më tepër me aftësitë organizative të tij, për shkak edhe të përvojës së pakët në detyrë. Nuk ka patur vonesa në arsyetimin e vendimeve, me përjashtim të 1 rasti civil, ku vonesa ka qenë 5 ditë (shih dosjen 3). Këto të dhëna tregojnë se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur”.

##### **4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, presumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.*

## **4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, presumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkallë të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, presumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, presumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.**

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Gjyqtari {...} i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjatë periudhës së rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 12 trajnime të organizuara nga kjo Shkollë, gjithsej 23 ditë të formimit vazhdues. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit së shkollës së parë, të paorganizuar në seksione. Nuk ka të dhëna për angazhimin e gjyqtarit {...} në aktivitet të tjera profesional, jashtë Shkollës së Magjistraturës”.

#### **4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.1598/3 prot., datë 19.07.2018, vërtetimit me nr. 531/1 prot., datë 18.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.531/1 prot., datë 18.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në 12 aktivitete të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 23 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese apo kohëzgjatjen minimale të këtij angazhimi. Ndërkohë, ky detyrim parashikohej në nenin 23 të ligjit nr.8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar,

sipas të cilit gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.

Aktualisht, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve. Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale. Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarit {...} në aktivitete trajnuese brenda programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë 20 pikë, meqenëse për periudhën 3 vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 23 ditë trajnimi. Kjo, pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarit në aktivitetet trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, si dhe kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë.



*Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M pikëzohet me 20 pikë.*

#### **4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e Shkollës së Magjistraturës, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë viti të stazhit profesional.

*Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013-2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjisllacionit etj.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtarin {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

#### **KONKLUZIONI**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

*Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.*

#### **4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE**

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të vetëvlerësimit profesional të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtarin {...} ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

## KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, pikëzohet me 0 pikë për këtë tregues.

*Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” gjyqtari pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

## NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	95	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	92	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	378	Shkëlqyeshëm

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE  
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}  
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016**

1. AFTËSITË PROFESIONALE			Piket total		Niveli i vlerësimit
			95		Shkëlqyeshëm
Treguesit		Burimet	Niveli	Piket	Të dhëna për metodologjinë
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumw e lartw	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Mbi mesataren	20	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
<b>2. AFTËSITË ORGANIZATIVE</b>				<b>Piket total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>92</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
<b>Tregues</b>		<b>Burimet</b>	<b>Niveli</b>	<b>Piket</b>	<b>Metodologjia</b>
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	0-10 %	15	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	0-10 %	5	<b>Jashtë afatit:</b> Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas</li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin	5	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve –

		fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	për të gjitha kategoritë e çështjeve		1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Mbi 93-99%	8	<b>Tej standardit :</b> Nën 81 % - 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	<b>Koha mesatare:</b> Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve –

					15 pikë
<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	<b>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Mbi mesataren	16	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Shumë e lartë	5	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);	Mbi mesataren	8	<b>Shkalla e aftësisë së gjyqtarit:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
<b>3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE</b>				<b>Piket total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>

				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	b. Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	35	<b>Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit:</b> E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	b. Dosja e rivlerësimit;	Shumë e lartë	40	<b>Shkalla e integritetit të gjyqtarit :</b> E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese:</b> E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	c. Dosja rivlerësimit;	e I pa konsiderueshëm	15	<b>Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit:</b>  Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
<b>4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL</b>				<b>Piket total</b>	<b>Niveli i vlerësimit</b>
				<b>91</b>	<b>Shkëlqyeshëm</b>
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
<b>A. Aftësia e</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të</li> </ul>	Shumë e lartë	25	<b>Qartësia dhe transparenca e komunikimit:</b>



<b>komunikimit</b>		përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> <li>▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);</li> </ul>	I lartë	15	<b>Respektimi i konfidencialitetit:</b> I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë	
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Shumë e lartë	15	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë	
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Shumë e lartë	10	<b>Shkalla e komunikimit:</b> E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë	
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	15-120 ditë	20	<b>Pjesëmarrja e gjyqtarit:</b> (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4	
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Nuk ka të dhëna		3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	gjkata				
	ç. Publikimi ligjore akademike	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dosja e rivlerësimit;</li> </ul>	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
<b>IVELI I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>		<b>SHKËLQYESHËM</b>			
<b>IKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>		<b>378</b>			